



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 4431/prot., Tiranë, më 20. 12. 2024

3

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 17624/1 prot., Tiranë, më 24. 1. 2024

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 549/1, datë 20. 12. 2024

PËR PROCEDURËN E PAGIMIT TË TARIFËS SË LICENCËS SË PRODHIMIT TË  
CANNABIS-IT PËR QËLLIME MJEKËSORE DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË  
KËSAJ TARIFE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 14, pika 9 dhe nenit 43, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së Cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministri i Financave:

UDHËZOJNË:

I. TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe përgjegjësive për pagesën e tarifës për pajisen me licencë për prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe për mënyrën e përdorimit të tarifës së licensimit.

II. VLERA DHE MËNYRA E PAGIMIT TË TARIFËS

1. Tarifa e përcaktuar në nenin 14, pika 9 të ligjit 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë. Kjo tarifë është e pakthyeshme.



2. Tarifa do të paguhet nga subjekti që kërkon të licencohet sipas faturës për arkëtim, referuar modelit të miratuar me Urdhrin nr. 35 datë 11.11.2009 të Ministrit të Financave "Për miratimin e faturës për arkëtim".
3. Subjekti, për të proceduar me pagesën, shkarkon nga faqa web e Agjencisë faturën për arkëtim.
4. "Fatura për arkëtim", paraqitet nga subjekti në bankën e nivelit të dytë për të kryer pagesën.
5. Banka e nivelit të dytë do të pranojë arkëtimin e tarifës vetëm me paraqitjen e faturës së plotësuar me të dhënat sipas modelit bashkëlidhur.
6. Dokumenti i lëshuar nga banka, që vërteton kryerjen e pagesës, dorëzohet pranë Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

### III. MËNYRA E PËRDORIMIT TË TARIFËS

Të ardhurat e përfituara nga kjo tarifë arkëtohen në llogarinë e të ardhurave të thesarit në favor të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it dhe përdoren sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646 datë 16.10.2024 "Për procedurën dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Albania KOCIU  
REPUBLICA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
TIRANË

MINISTRI I FINANCEVE

Petrit MALAJ  
REPUBLICA E SHQIPËRI  
MINISTRI I FINANCEVE